

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

PARKTECH BALKANS

Sot, më datë 17.05.2022, personalisht:

- **Alessandra MORELLI**, e bija e Roberto-s, e datëlindjes 02.05.1978, shtetase italiane, lindur ne Pescara, Itali dhe banuese ne Rr.S.Damato, Pescara, Itali, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut te vetem të shoqërisë tregtare PARKTECH BALKANS Sh.p.k.

Përpilon këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare **PARKTECH BALKANS sh.p.k.**, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Të themelojë Shoqërinë Tregtare PARKTECH BALKANS Sh.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri PARKTECH BALKANS Sh.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit PARKTECH BALKANS Sh.P.K dhe me emrin tregtar PARKTECH BALKANS. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4 Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

Prodhim dhe montim Impiamte parkimi makinash per vete ose per te trete. Punime mekanike, hekuri, tomo, saldım dhe lyerje e tyre, montim te paisjeve elektrike. Mbikqyrje dhe kolaudim.



NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Fshati Gjec-Kodër, Rruga Qendër, Nr.9, Njësia administrative Prezë, Bashkia Vorë, Tirane.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

NENI 6 Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar eshte 100.000 (njeqind mije) Lek dhe zotërohet nga ortaku themelues.

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: 100.000 leke, vlere e cila eshte paguar plotesisht.

Numri total i kuotave: 1.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

NENI 7

Ortaku i vetem themelues i Shoqërisë Tregtare PARKTECH BALKANS Sh.p.k zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Alessandra MORELLI: pjesemarrja ne perqindje 100 %, 1 kuotë, lloji i kontributit para, 100.000 (njeqind mije) Leke, kontribut i cili eshte paguar plotesisht dhe menjëherë.

NENI 8 Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Ortaku i Vetem – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.


NENI 9 Administratori

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 4 (kater) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë **Z. Skënder Shaban LAMI**.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Ortaku mund të vendose me vullnetin e tij, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.



NENI 11

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Te dhena qe njoftohen vullnetarisht:

Emri tregtar: PARKTECH BALKANS

Email : marketing@parktech.it

Tel : 069 47 26010

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortakja e vetme eshte njohese e gjuhes shqipe.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Alessandra MORELLI

Alessandra Morelli
